



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

PROCESI I VETËVLERËSIMIT TË OFRUESVE PUBLIKË DHE JO PUBLIKË TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

RAPORT KOMBËTAR PËR PROCESIN DHE REZULTATET

PERIUDHA E VETËVLERËSIMIT

2023-2024

SHKURTIMET

AFP	Arsim dhe Formim Profesional
IoAFP	Institucion ofrues i Arsimit dhe Formimit Profesional
SD4E	Programi i Zhvillimit të Aftësive për Punësim
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
MEI	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
AKAFP	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
QFP	Qendër e Formimit Profesional
Qa	Sigurimi i Cilësisë
SKPA	Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
NJZH	Njësia e Zhvillimit
OJF	Organizata jofitimprurëse
PEI	Plane Edukative Individuale

PËRMBLEDHJE

Mbështetur në Udhëzimin nr. 18, datë 6.7.2021, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “*Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 8.5.2018, “Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”*”, ofruesit publikë dhe jo publikë të AFP-së kanë zbatuar si çdo vit procesin e vetëvlerësimit sipas kalendarit të hartuar nga AKAFPK, kanë mbledhur të dhënat dhe kanë hartuar raportin përfundimtar të vetëvlerësimit.

Në përfundim të procesit të vetëvlerësimit për vitin 2023-2024, u grumbulluan të gjitha raportet e dërguara nga ofruesit e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP). Këto raporte u analizuan nga sektori i akreditimit të ofruesve të AFP-së gjatë muajve shkurt-tetor 2025, me qëllim përgatitjen e raportit përmbledhës mbi rezultatet e vetëvlerësimit në nivel kombëtar.

Ky raport përmbledhës paraqet kuadrin historik dhe rregullator të sigurimit të cilësisë në sistemin e AFP-së në Shqipëri, duke evidentuar institucionet shtetërore të përfshira dhe rolet e tyre përkatëse.

Më tej, raporti përshkruan metodologjinë e ndjekur për vetëvlerësimin si dhe kalendarin e zbatimit për vitin 2023-2024. Janë prezantuar rezultatet e vetëvlerësimit për të pesë fushat e cilësisë, të mbështetura nga analiza cilësore dhe sasiore e të dhënave të mbledhura si nga raportet e dërguara, ashtu edhe nga platforma scvet.al.

Në përfundim të analizës së të dhënave, janë formuluar rekomandime të detajuara, të cilat synojnë të adresojnë fushat ku nevojiten përmirësime konkrete.

KONTEKSTI HISTORIK

Sistemi i AFP-së në Shqipëri është një sistem kryesisht me bazë shkollën dhe Qendrat e Formimit Profesional. Në sistemin e AFP-së, AKAFPK ka zhvilluar një cikël koherent politikash të proceseve të brendshme për zhvillimin dhe ruajtjen e kualifikimeve profesionale i cili mbështet rëndësinë e kualifikimeve për tregun e punës. Në sfondin e politikave, prej disa vitesh janë bërë përpjekje të shumta për ta zhvendosur fokusin drejt AFP-së dhe rezultatet kanë qenë të dukshme, ndër të cilat mund të përmendim aktivizimin për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe kuadrit të kualifikimeve profesionale, përmirësimin e procesit të të nxënies duke e vënë theksin te rëndësia e të nxënies me bazë punën, rritjen e ndjekjes së shkollave profesionale, promovimin e AFP-së përmes aktiviteteve promovionale dhe konkurruese etj. Një përpjekje që ka dhënë rezultate pozitive është gjithashtu pjesëmarrja e biznesit në bordet e shkollave, me synim rritjen e kontributit të sektorit jopublik dhe pjesëmarrjen më aktive dhe më efikase të tij në AFP, duke plotësuar hendequn që ekziston mes arsimit profesional dhe tregut të punës, si dhe duke rritur cilësinë.

Projekti SD4E, në bashkëpunim të ngushtë me AKAFPK dhe grupe të tjera interesi, punoi për të përcaktuar tiparet e dëshiruara dhe fizibilitetin e sistemit të sigurimit të cilësisë. Tashmë viti

shkollor 2023-2024 ishte viti i shtatë i zbatimit të procesit të vetëvlerësimit, i cili dëshmon për një rritje të ndërgjegjësimit të ofruesve të AFP-së për rolin e vetëvlerësimit në sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Kriteret dhe standardet minimale të pranuar, pjesë e instrumentit të vetëvlerësimit, janë zbatuar edhe këtë vit nga të gjithë ofruesit publikë dhe jo publikë të AFP-së në Shqipëri. Këto standarde dhe kriteret përbëjnë bazën e modelit të sigurimit të cilësisë dhe akreditimit në AFP drejt modernizimit të kontekstit të arsimit profesional dhe garancisë që të diplomuarit e AFP-së të kenë njohuritë dhe kualifikimet për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës.

Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit nga 41 ofrues publikë dhe jo publikë të AFP-së ka evidentuar aspektet pozitive, si dhe aspektet problematike, në të pesë fushat e cilësisë. Rezultatet e vetëvlerësimit të ofruesve të AFP-së janë konsideruar nga secili prej tyre për hartimin e raportit kombëtar të vetëvlerësimit.

KUADRI RREGULLATOR PËR VETËVLETËSIMIN (QA) NË SISTEMIN E AFP-SË NË SHQIPËRI

Kuadri strategjik

Kuadri strategjik në AFP lidhet me Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030, miratuar me Vendim nr. 173, datë 24.3.2023, *“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030*. Vizioni dhe objektivat e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 janë pjesë e rëndësishme e angazhimit të Shqipërisë për zbatimin e Agjendës 2030 dhe i shërbejnë arritjes së Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm në vend.

Kuadri ligjor

Ligji nr. 15/2017, datë 16.2.2017 i ndryshuar “Për arsimin dhe formimin profesional”, kreu V “Sigurimi i Cilësisë” përcakton bazën për zhvillimin e një kuadri të sigurimit të cilësisë në sistemin shqiptar të AFP-së, duke përfshirë licencimin, vetëvlerësimin, inspektimin dhe akreditimin.

Ligji nr. 10247, datë 4.3.2010 *“Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”* (KSHK), i ndryshuar dhe i përmirësuar në vitin 2018 (*Ligji nr. 23/2018, datë 10.5.2018*), përshkruan veçoritë kryesore të KSHK-së, si strukturën, fushën e veprimit, objektivat dhe funksionet, si dhe masat për qeverisjen, menaxhimin institucional, sigurimin e cilësisë dhe financimin. Fokusi kryesor i parashikuar nga ligji, ndër shumë të tjera, thekson çështjen e sigurimit të cilësisë në AFP. Kjo do të thotë që të gjitha institucionet e arsimit dhe formimit profesional duhet të plotësojnë standarde të caktuara të cilësisë përsa i përket burimeve njerëzore dhe fizike, sistemeve dhe procedurave, menaxhimit, procesit të të nxënies etj. Sigurimi i cilësisë duhet të jetë guri i themelit i çdo institucioni që ofron arsim dhe formim profesional dhe një aspekt shumë i rëndësishëm për përmirësimin e imazhit të AFP-së dhe prodhimin e një force punëtore të kualifikuar për tregun e punës.

Për më tepër, kuadri ligjor për arsimin parauniversitar (Ligji nr. 69/2012 dhe legjislacioni dytësor përkatës) parashikon rregullat dhe kriteret për kuadrin e zhvillimit institucional dhe të cilësisë, veçanërisht për ofruesit e AFP-së që ofrojnë programe të arsimit të mesëm të lartë. Janë përcaktuar procedura dhe kriteret të qarta lidhur me : 1) planin strategjik afatmesëm (4 vjeçar); 2) planin vjetor të punës dhe 3) fushën e veprimit, zbatimin dhe përdorimin e vetëvlerësimit të institucioneve parauniversitare, duke përfshirë shkollat e AFP-së.

Kuadri institucional për sigurimin e cilësisë në AFP

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

Me vendimin nr. 30, datë 17.1.2024, *“Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”*, arsimi dhe formimi profesional përfshihet në fushën e ekonomisë, në ministrinë e sapokrijuar, ku citohet në pikën 3, 3/1, gërma ç) të vendimit.

Në cilësinë e institucionit më të lartë përgjegjës për politikën e AFP-së, edhe për vitin shkollor 2023-2024, shkollat e mesme të arsimit profesional dhe Qendrat e Formimit Profesional kanë qenë në varësinë e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. MEKI ka patur si detyrë krijimin e kuadrit të sigurimit të cilësisë në sistemin e AFP-së, duke përfshirë të gjithë komponentët e këtij sistemi, siç janë licencimi, hapja dhe mbyllja e ofruesve publikë dhe jo publikë të AFP-së, si dhe miratimi i legjislacionit dytësor për akreditimin, vetëvlerësimin, monitorimin dhe inspektimin. Më konkretisht, Ministria është përgjegjëse për zhvillimin e bazës ligjore, garantimin e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare dhe sigurimin e infrastrukturës. Në sektorin publikë dhe jo publikë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka qenë përgjegjëse për miratimin e hapjes, organizimit dhe mbylljes së ofruesve publikë dhe jo publikë të AFP-së mbi bazën e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Ajo ka miratuar ofrimin e programeve të AFP-së në bazë të kualifikimeve kombëtare të ofruara nga ofruesit publikë dhe jo publikë të AFP-së dhe ka miratuar modelin, standardet dhe kriteret e akreditimit të propozuara nga AKAFPK.

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit

Ndërsa me Vendimin nr. 516, datë 25.9.2025 *“Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit”*, u miratua fusha e përgjegjësisë së këtij institucioni, e cila garanton të drejtën për arsim dhe formim profesional, punësim të sigurt e të denjë.

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)

AKAFPK është institucioni përgjegjës për krijimin e një sistemi të unifikuar të kualifikimeve profesionale të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, një sistem që u mundëson nxënësve/kursantëve/individëve të fitojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca për të përballuar sfidat e zhvillimit social-ekonomik të vendit. AKAFPK mbështet ministrinë përgjegjëse për të forcuar

dimensionin evropian të sistemit shqiptar të kualifikimeve. Në sektorin e AFP-së, AKAFPK ka përgjegjësi dhe kompetencë të plotë për të ushtruar funksionet kryesore të KSHK-së. Ndër detyrat e tjera dhe në lidhje me zbatimin e ligjit për KSHK-në, AKAFPK kryen vlerësimet e kualifikimeve profesionale dhe i krahason ato me kualifikimet ndërkombëtare, si dhe propozon ndryshime në kriteret dhe procedurat për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve të përfshira në KSHK.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)

Bazuar në nenin 9 të ligjit për AFP-në, i ndryshuar, AKPA është përgjegjëse për menaxhimin e rrjetit të ofruesve publikë dhe jo publikë të AFP-së. Me këtë detyrë, AKPA është përgjegjëse për monitorimin e veprimtarisë së përditshme të ofruesve të AFP-së. Krahas kësaj, AKPA-s i është besuar detyra e mirëmbajtjes dhe përditësimit të regjistrit kombëtar të certifikatave, si dhe detyra e gjurmimit të nxënësve të AFP-së pas diplomimit/certifikimit.

INSTRUMENTI DHE METODOLOGJIA E VETËVLERËSIMIT

Metodologjia e vetëvlerësimit në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) bazohet në pesë dimensionet kryesore të cilësisë së veprimtarisë së ofruesve të AFP-së. Procesi është udhëhequr nga një instrument vetëvlerësimi, i hartuar me mbështetjen e programit SD4E, i cili ka shërbyer si udhëzues për zbatimin e këtij procesi në mënyrë të standardizuar dhe të plotë.

Ky instrument përmban përshkrime të detajuara për secilën fushë dhe nënfushë të vetëvlerësimit, si dhe përfshin kriteret, standardet dhe nivelet përkatëse të vlerësimit. Struktura e tij ndihmon ofruesit të kuptojnë qartë kërkesat dhe pritshmëritë për secilin aspekt të cilësisë, duke siguruar një proces të unifikuar dhe të matshëm vlerësimi. **Fusha** nënkupton një dimension themelor të veprimtarisë së ofruesit të AFP-së dhe lidhet drejtpërdrejt me të gjithë veprimtarinë e tij. Përcaktimi i fushave të veprimtarisë bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore për arsimin profesional dhe arsimin e përgjithshëm. Janë përcaktuar këto fusha kryesore të vetëvlerësimit:

- I. Menaxhimi
- II. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi
- III. Kurrikula e zbatuar
- IV. Mësimdhënia dhe të nxënit
- V. Vlerësimi

Nënfusha është një nën-ndarje me detaje dhe elemente që tregon dhe plotëson më së miri përmbajtjen e një fushe të caktuar në të cilën punon ofruesi i AFP-së. Për shembull, nëse njëra nga fushat është “*Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi*”, nënfushat janë “*Marrëdhëniet me komunitetin dhe shoqërinë civile*”, “*Marrëdhëniet me biznesin*” etj.

Këto nënfusha synojnë të identifikojnë se çfarë marrëdhëniesh dhe çfarë forma bashkëpunimi ka institucioni i AFP-së me partnerët e tij. Ato konsiderohen si një mundësi për të identifikuar, për të

vëzhguar dhe për të vlerësuar në imtësi atë që ndodh brenda ofruesit të AFP-së. Pra nënfushat kryejnë dy funksione:

- zbërthejnë fushën në elementë organike të domosdoshme për të;
- mundësojnë njohjen dhe vlerësimin real të situatës brenda ofruesit të AFP-së.

Treguesi është një fjali e matshme pohuese që tregon se si është dhe si duhet të jetë fusha. Përmes treguesve, ne vlerësojmë se si është vetëvlerësuar ofruesi i AFP-së.

Karakteristikat e treguesve:

- hartohen për secilën nënfushë dhe mund të jenë një ose disa të tillë;
- janë gjithnjë të matshëm, gjë që do të thotë se ata lehtësojnë procesin e vetëvlerësimit;
- paraqesin pohime që specifikojnë fushën që do të vlerësohet.

Kriteri është një nën-ndarje e treguesve i shprehur në formën e një fjalie që përcakton si është zbatuar, si është organizuar apo në ç'gjëndje paraqitet treguesi. Ai sugjeron mbledhjen e informacioneve dhe mundëson arritjen e treguesve nga institucioni i AFP-së.

Nivelet e vlerësimit janë nivelet e përdorura për vlerësimin e institucionit të AFP-së nëpërmjet fushave të tij. Vlerësimi kryhet për çdo kriter të secilit tregues të një fushe. Nivelet e vlerësimit janë katër: shumë mirë, që përkon me numrin 1; mirë, që përkon me numrin 2; mjaftueshëm, që përkon me numrin 3; dhe dobët, që përkon me numrin 4. Skema me katër nivele vlerësimi është mjaft e përdorur në vlerësimet e ofruesve të AFP-së në vendet e Evropës. Po ashtu, ky sistem me katër nivele mundëson një vlerësim real dhe përfshin të gjitha nivelet që mund të arrijnë institucionet e AFP-së sipas treguesve.

Standardi është përshkrimi i situatës së ofruesit të AFP-së për secilën fushë, i cili mundëson një vlerësim sipas niveleve të mësipërme të vlerësimit. Ky vlerësim është rezultat i përpunimit të të dhënave të instrumenteve të monitorimit dhe vlerësimit të siguruara për secilin tregues dhe kriter, por edhe i të dhënave të siguruara nga metodologjia e zbatuar gjatë vlerësimit të brendshëm. Vlerësimi përfundimtar për një fushë specifike bazohet gjithmonë në peshën dhe rëndësinë e zbatimit të secilit tregues dhe kriter në situatën e ofruesit të AFP-së.

KALENDARI I ZBATIMIT TË PROCESIT TË VETËVLERËSIMIT 2023-2024 NË OFRUESIT E AFP-SË

Nr.	Hapat që duhen ndërmarrë	Afatet	Personat përgjegjës
1	Krijimi i ekipit përgjegjës të vetëvlerësimit	7 tetor 2024	Drejtuesi i IoAFP-së
2	Miratimi i ekipit përgjegjës të vetëvlerësimit nga këshilli i mësimdhënësve	11 tetor 2024	Këshilli i mësimdhënësve
3	Hartimi i planit të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë	18 tetor 2024	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit
4	Miratimi i planit të vetëvlerësimit nga drejtuesi i IoAFP-së	22 tetor 2024	Drejtuesi i IoAFP-së
5	Zbatimi i procesit të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë duke përdorur edhe platformën digjitale www.scvet.al (plotësimi i pyetësorëve, vëzhgime, mbledhje informacioni, etj.)	29 dhjetor 2024	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit/ Drejtuesi i IoAFP-së/Bordi i IoAFP-së/ mësimdhënësit/Stafi mbështetës/ nxënësit/kursantët/ bizneset
6	Përpunimi i të dhënave dhe hartimi i raportit të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë, duke përfshirë në raport “Instrumentin për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë”	15 janar 2025	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit
7	Përgatitja e raportit final të vetëvlerësimit për 5 fushat e cilësisë	5 shkurt 2025	Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit
8	Monitorimi dhe mbështetja e procesit të vetëvlerësimit nga specialistë të AKAFPK-së	tetor 2024-shkurt 2025	Specialistë të AKAFPK-së
9	Prezantimi i raportit final të vetëvlerësimit në këshillin e mësimdhënësve dhe miratimi i tij nga bordi i IoAFP-së	7 Shkurt 2025	Drejtuesi i IoAFP-së/ këshilli i mësimdhënësve /Bordi i IoAFP-së
10	Hedhja e raportit final të vetëvlerësimit në platformën digjitale www.scvet.al	10 shkurt 2025	Drejtuesi i IoAFP-së

REZULTATET E PROCESIT TË VETËVLERËSIMIT 2023-2024

Procesi i vetëvlerësimit për vitin 2023-2024 u finalizua nga **41 ofrues të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP)**, të cilët dorëzuan raportet përkatëse të vetëvlerësimit. Rezultatet e këtyre raporteve u përpunuan dhe analizuan nga specialistët e **AKAFPK-së**, në sektorin e akreditimit të ofruesve të AFP-së, përmes shqyrtimit të të dhënave cilësore dhe sasiore të mbledhura nga raportet dhe nga platforma **scvet.al**.

Në kuadër të këtij procesi, AKAFPK-ja zhvilloi **takime individuale me secilin nga 41 ofruesit**, duke ofruar mbështetje në realizimin e vetëvlerësimit, komunikimin e progresit të arritur dhe diskutimin e fushave që kërkojnë përmirësim.

Raporti përmblendhës trajton në mënyrë të strukturuar të gjitha **nënfushat e pesë fushave të cilësisë**, të cilat përbëjnë bazën e instrumentit të vetëvlerësimit. Secila nënfushë paraqitet në dy pjesë: në pjesën e parë renditet **rezultati i arritur**, ndërsa në pjesën e dytë evidentohen **dobësitë** dhe mundësitë për përmirësim.

Në vijim të raportit, janë paraqitur **rezultatet sasiore në formë grafike** për secilin ofrues, krahas **analizës cilësore** të të dhënave. Në përfundim, janë **formular rekomandime specifike** për adresimin e çështjeve që kërkojnë ndërhyrje në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.

FUSHA 1: MENAXHIMI DHE DREJTIMI

Ofruesit institucionalë të Arsimit dhe Formimit Profesional (IoAFP) kanë zbatuar me përkushtim dhe përpikmëri procesin e vetëvlerësimit për vitin 2023-2024, duke dorëzuar raportet përkatëse pranë AKAFPK-së brenda afateve të përcaktuara në kalendarin zyrtar.

Gjatë verifikimit të fushës së parë, “Menaxhim dhe drejtim”, IoAFP-të kanë demonstruar aftësi të mirëfillta organizative, përmes ngritjes së grupeve të punës, ndarjes së qartë të roleve dhe përcaktimit të proceseve për secilin grup.

Është vlerësuar gjithashtu një përfshirje domethënëse e stafit mësimor, i cili ka kontribuar në hartimin e raportit të vetëvlerësimit. Ky bashkëpunim ka bërë të mundur zhvillimin e një procesi transparent, gjithëpërfshirës dhe me natyrë bashkëpunuese.

Më poshtë janë listuar nënfushat përkatëse, së bashku me zhvillimet që ato paraqesin në nivel kombëtar për të gjithë IoAFP-të.

1. Gjithëpërfshirja
2. Plani afatmesëm i ofruesve të AFP-së

3. Plani vjetor i ofruesve të AFP-së
4. Plani i vëzhgimit të orëve mësimore
5. Plani i monitorimit të dokumentacionit institucional
6. Statistikat e ofruesve të AFP-së, regjistrimi dhe transferimi i nxënësve
7. Vetëvlerësimi/vlerësimi i brendshëm i ofruesve të AFP-së
8. Zhvillimi profesional i stafit
9. Efektiviteti i burimeve njerëzore dhe financiare

1. Gjithëpërfshirja

a. Rezultati

Strukturat e IoAFP-ve, si Bordi i IoAFP-së, Këshilli i Mësuesve, Qeveria e Nxënësve, Këshilli i Prindërve të IoAFP-së, Këshilli i Prindërve të Klasës, Komisioni i Disiplinës, dhe Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, operojnë sipas planit vjetor të aktiviteteve. Ky bashkëpunim i ngushtë dhe i koordinuar midis strukturave është vënë në dukje përmes dokumentacionit të mbajtur dhe ka sjellë një avancim të dukshëm në funksionimin e institucioneve. Po ashtu, drejtoritë sigurohen që të realizohen takime periodike, në të cilat merren parasysh mendimet dhe sugjerimet e stafit për përmirësimin e performancës dhe përparimit të përgjithshëm të institucionit.

b. Dobësitë

Përfshirja e prindërve ka qenë një çështje e ndërlikuar, e cila është pasojë e kontekstit social dhe kulturor. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të IoAFP-ve, kjo dobësi ka ende hapësirë për t'u adresuar plotësisht. Këshilli i Prindërve, krahasuar me strukturat e tjera, ka pasur një nivel më të ulët të angazhimit dhe shpesh ka funksionuar pa një plan të miratuar paraprakisht për aktivitete, gjë që ka ndikuar në organizimin e veprimtarive të tij.

2. Plani afatmesëm i ofruesve të AFP-së

a. Rezultati

Planet afatmesme tashmë shfaqin një përmirësim të dukshëm në cilësinë e hartimit të tyre, duke iu përgjigjur më mirë kërkesave të strategjisë kombëtare të punësimit dhe nevojave të tjera për përgatitjen e tyre. Megjithatë, edhe pse ka një progres të dukshëm, ende ka mundësi për përmirësime të tjera për të arritur një prezantim të plotë dhe optimal të këtyre planeve.

b. Dobësitë

Një dobësi që mund të ndikojë në efektivitetin e planeve afatmesme është mungesa e ekipeve mbikëqyrëse për monitorimin dhe zbatimin e tyre. Këto ekipe janë kyçe për sigurimin e realizimit të rezultateve të planifikuara nga IoAFP-të. Prandaj, rekomandohet që të krijohen ekipe mbikëqyrëse atje ku nuk janë formuar ende, si dhe të përforcohen dhe bëhen më aktive në ato institucione që tashmë disponojnë ekipe të tilla.

3. Plani vjetor i ofruesve të AFP-së

a. Rezultati

Ofruesit e AFP-së hartojnë planet vjetore që janë një pasqyrim më të hollësishëm të planeve afatmesme. Këto plane hartohen nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë midis aktorëve të brendshëm, të cilët gjithashtu ofrojnë sugjerime të vlefshme që merren parasysh gjatë formulimit të tyre. Për më tepër, plani vjetor kalon një proces verifikimi dhe miratimi nga Bordi i ofruesit, duke siguruar një kontroll të plotë dhe të strukturuar.

b. Dobësitë

Një nga sfidat kryesore që mbetet për t'u adresuar është integrimi i objektivave që përfshijnë veprimtari me dimension gjinor në planet vjetore. Disa IoAFP raportojnë se këto aktivitete janë përfshirë vetëm pjesërisht ose aspak, duke treguar se ka ende hapësirë për përmirësim në këtë drejtim.

4. Plani i vëzhgimit të orëve mësimore

a. Rezultati

Plani i vëzhgimit të orëve mësimore zbatohet në përputhje me kërkesat ligjore dhe është realizuar në mënyrë të sistematizuar nga shumica e Drejtuesve të IoAFP-ve. Vëzhgimet bëhen me rregull dhe dokumentohen për të siguruar përmirësimin e veprimtarive të mësimdhënies dhe për të monitoruar ecurinë e nxënësve, duke u siguruar që ky proces të kontribuojë në rritjen e cilësisë.

b. Dobësitë

Ka pasur referime që cilësia e dokumentimit dhe matjes së punës duhet të përmirësohet, duke përfshirë këtu krijimin e një formati dhe raporti standard për vëzhgimin e orëve, që do të mbulonte këto aspekte të rëndësishme.

5. Plani i monitorimit të dokumentacionit institucional

a. Rezultati

Ofruesit e AFP-së kanë arritur të krijojnë një sistem efektiv për planifikimin, ndjekjen dhe monitorimin e plotësisht dhe ruajtjes së dokumentacionit institucional. Ky proces është bërë i qëndrueshëm dhe i mirëorganizat, duke garantuar që të dhënat dhe informacionet e nevojshme për funksionimin e institucionit janë të disponueshme dhe të menaxhuara në mënyrë profesionale.

b. Dobësitë

Një mangësi e dukshme që ka dalë në pah për një numër të konsiderueshëm ofruesish është mungesa e transparencës në dokumentimin e librit të inventarit. Ky libër duhet të jetë një burim i qartë dhe i lehtë për tu aksesuar, si për IoAFP-të ashtu edhe për komunitetin. Megjithatë, për disa ofrues, ky dokument nuk është plotësisht i hapur dhe i aksesueshëm, gjë që mund të krijojë pasiguri dhe mundësi për keqkuptime lidhur me menaxhimin e burimeve dhe pasurisë institucionale.

Prandaj, rekomandohet që të forcohet procesi i krijimit dhe mbajtjes së librit të inventarit si një dokument transparent dhe të mundshëm për kontroll dhe verifikim nga të gjitha palët e interesuara.

6. Statistikat e ofruesve të AFP-së, regjistrimi dhe transferimi i nxënësve/kursantëve

a. Rezultati

Procedurat e regjistrimit dhe transferimit të nxënësve/kursantëve janë të strukturuar dhe zhvillohen në përputhje me udhëzimet e përcaktuara. Ofruesit kanë krijuar dhe administruar databaza të përshtatshme, duke siguruar mbajtjen e të dhënave statistikore të rëndësishme për operacionet e përditshme dhe për raportimin tek institucionet mbikëqyrëse. Ky sistem mbështet transparencën dhe ndihmon në monitorimin e fluksit të nxënësve/kursantëve, duke garantuar një menaxhim të saktë të të dhënave.

b. Dobësitë

Janë evidentuar pak raste ku mungon një monitorim i sistematik i të dhënave, që mund të çojë në humbje informacioni ose në pasaktësi të të dhënave.

7. Vetëvlerësimi/vlerësimi i brendshëm i ofruesve të AFP-së

a. Rezultati

IoAFP-të realizojnë vlerësimin e brendshëm vjetor, duke ndjekur udhëzimet përkatëse dhe duke krijuar grupe pune të dedikuara për zhvillimin dhe implementimin e këtij procesi. Ky proces i brendshëm i vlerësimit është një hap i rëndësishëm për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga institucionet.

b. Dobësitë

Megjithatë, disa mangësi kanë dalë në pah gjatë realizimit të këtij procesi. Një problem i dukshëm është se nuk të gjithë mësimdhënësit kryejnë vetëvlerësimin duke përdorur instrumente standardizuar, si dhe disa ekipe të drejtimit profesional nuk e realizojnë këtë veprimtari, duke bërë procesin të pasaktë dhe jo të plotë. Po ashtu, një problematikë që është vazhduar për disa vite është mospublikimi i raporteve përfundimtare të vlerësimit në faqet e internetit të ofruesve. Një numër i konsiderueshëm i institucioneve nuk disponojnë faqe funksionale ose ato janë të pasigurta, çka pengon transparencën dhe mundësinë e aksesit të gjerë për komunitetin dhe palët e interesuara.

8. Zhvillimi profesional i stafit

a. Rezultati

Drejtuesit e ofruesve të AFP-së kanë përgjegjësi të qarta në menaxhimin e zhvillimit profesional të stafit dhe angazhohen aktivisht në organizimin e trajnimeve dhe kualifikimeve të nevojshme për personelin. Nevojat për trajnim dhe kualifikim identifikohen në kohë dhe përpunohen në përputhje me kërkesat dhe standardet zyrtare, duke siguruar që çdo anëtar i stafit të ketë mundësi për rritje profesionale dhe përmbushje të kërkesave të institucionit.

b. Dobësitë

Një mangësi që është evidentuar është mungesa e një plani të strukturuar për shkëmbimin e përvojave profesionale midis mësuesve, si dhe brenda grupeve kurrikulare. Shumë ofrues nuk kanë krijuar mundësi të rregullta për mësuesit për të shkëmbyer përvoja dhe njohuri përmes takimeve profesionale, si në formatin e takimeve të drejtpërdrejta ashtu edhe nëpërmjet platformave online. Ky mungesë mund të kufizojë zhvillimin e bashkëpunimit dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies, duke mos shfrytëzuar plotësisht mundësitë e shkëmbimit të eksperiencave dhe njohurive të reja.

9. Efektiviteti i burimeve njerëzore dhe financiare


a. Rezultati

Drejtuesit e IoAFP-ve menaxhojnë me efikasitet burimet njerëzore dhe financiare që disponojnë, duke identifikuar në kohë nevojat për personel shtesë ose burime financiare për të siguruar zhvillimin e aktivitetit të institucionit. Buxheti i miratuar nga institucionet përgjegjëse menaxhohet gjithmonë në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet financiare. Po ashtu, burimet njerëzore janë të angazhuara me detyra të qarta dhe të përcaktuara, duke u inkurajuar që të punojnë në një atmosferë bashkëpunimi dhe koordinimi të suksesshëm midis kolegëve dhe ekipeve të ndryshme. Buxheti i ofruesve menaxhohet konform akteve ligjore.


b. Dobësitë

Dobësia e evidentuar ka të bëjë me faktin se disa ofrues përballen me vështirësi në sigurimin e pjesëmarrjes aktive të të gjithë mësimeve në veprimtaritë ndërkurrikulare që organizohen.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet vlerësimi për secilin prej 41 ofruesve të AFP-së, për fushën 1 “Menaxhimi dhe drejtimi”.



Nga analiza e rezultateve të vetëvlerësimit u arrit në përfundimin se 37 prej ofruesve publikë dhe jo publikë të AFP-së e kanë vlerësuar veten “Shumë mirë” për fushën 1. 4 prej ofruesve publikë dhe jo publikë të AFP-së e kanë vlerësuar veten “Mirë” dhe “Mjaftueshëm” ose “Dobët” nuk është vlerësuar asnjë prej ofruesve.



FUSHA 2 - MARRËDHËNIET DHE BASHKËPUNIMI

Fusha e dytë e vetëvlerësimit fokusohet në “Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimin”, një komponent kyç për vlerësimin e nivelit të bashkëpunimit që zhvillon ofruesi i Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP). Kjo fushë shërben si një pikë referimi për matjen e suksesit dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit.

Ofruesit e AFP-së gëzojnë një autonomi të gjerë në zgjedhjen dhe zhvillimin e formave të bashkëpunimit, me qëllim rritjen e cilësisë, profesionalizimit dhe efektivitetit të shërbimeve të ofruara. Këto veprimtari bashkëpunuese kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e besueshmërisë institucionale si dhe në forcimin e pozicionit konkurrues në tregun e punës dhe sistemin e arsimit profesional.

Fusha 2 përbëhet nga katër nënfushat në vijim:

1. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore, rajonale dhe vendore.
2. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin.
3. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe komunitetin

4. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis vet ofruesve të AFP-së dhe institucioneve.

1. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore, rajonale dhe vendore

a. Rezultati

Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis IoAFP-ve dhe institucioneve qendrore dhe lokale të arsimit dhe çështjeve të AFP-së janë të stabilizuara dhe karakterizohen nga një bashkërendim i mirë. Kërkesat ligjore zbatohet në mënyrë rigorozë, me komunikime të rregullta dhe zyrtare, raportime të herëpashershme dhe ftesa për pjesëmarrje në aktivitete të përbashkëta. Ky bashkëpunim ka kontribuar në përmirësimin e performancës dhe në forcimin e lidhjeve midis institucioneve të ndryshme që janë të përfshira në fushën e arsimit dhe formimit profesional.

b. Dobësitë

Megjithatë, në nivelin e bashkëpunimit me qeverisjen vendore, IoAFP-të kanë arritur të forcojnë marrëdhëniet me institucionet vendore, por ende hasen disa problematika që kërkojnë vëmendje. Një çështje e vazhdueshme është mungesa e një bashkëpunimi të plotë dhe të strukturuar për zhvillimin e praktikave profesionale brenda institucioneve të qeverisjes lokale. Shumë ofrues ende nuk kanë arritur të krijojnë mundësi efektive për shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta me administratën lokale. Gjithashtu, një problematikë që ka mbetur e pandryshuar ndër vite është planifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve me aspekte gjinore në bashkëpunim me pushtetin lokal dhe institucionet vendore. Edhe pse disa ofrues kanë marrë masa për të përmirësuar këtë aspekt, ato ende nuk kanë rezultuar të efektshme, duke penguar përparimin e barazisë gjinore në nivelin lokal.

2. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin

a. Rezultati

Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin janë konsoliduar dhe kanë mbetur në një nivel të qëndrueshëm, pa ndryshime të theksuara nga viti i kaluar. Komunikimi dhe bashkëveprimi midis IoAFP-ve dhe bizneseve realizohet përmes Njesisë së Zhvillimit, e cila dokumenton dhe menaxhon marrëdhëniet me bizneset. Këto dokumente përfshijnë planet periodike, marrëveshjet dhe kontratat standarde, si dhe databazat e bizneseve dhe evidencat për praktikatat e nxënësve.

b. Dobësitë

Megjithatë, disa pika të dobëta vazhdojnë të mbeten të dukshme ndër vite. Njëra prej tyre është planifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve me aspekte gjinore në bashkëpunim me biznesin, ku masat e marra nga ofruesit ende nuk kanë pasur efektet përmirësuese të pritura. Mungesa e avancimit në këtë drejtim ka ndikuar në zhvillimin e mundësive për barazi gjinore në praktikatat e punës dhe në

trajnimin e nxënësve. Po ashtu, një çështje tjetër e theksuar është mungesa e përpikmërisë nga disa ofrues për të kryer analiza të tregut për zonën e veprimtarisë së tyre. Disa ofrues nuk i realizojnë këto analiza të detajuara, ose i kryejnë ato për një numër të kufizuar kualifikimesh, duke lënë mënjanë kualifikime të tjera që kërkojnë përditësim. Për më tepër, Njësia e Zhvillimit e disa ofruesve ka hasur vështirësi në identifikimin e punonjësve të kualifikuar në bizneset përkatëse, të cilët mund të kontribuojnë në zhvillimin e temave dhe përmbajtjeve në shkollë. Ky problem ka kufizuar mundësitë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme edukative dhe praktike që mund të kishin përfituar nga eksperiencia e punonjësve të kualifikuar.

3. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe komunitetin

a. Rezultati

Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin kanë arritur një nivel konsolidimi, i cili mbetet i qëndrueshëm, por pa përmirësime të dukshme ose zhvillime të reja. Komunikimi dhe bashkëveprimi midis IoAFP-ve dhe sektorit privat realizohet përmes Njesisë së Zhvillimit, e cila mbikëqyr dhe menaxhon këto marrëdhënie duke përdorur një sistem dokumentimi të detajuar. Këto dokumente përfshijnë planet periodike, marrëveshjet, kontratat standarde, si dhe databazën e bizneseve, ku regjistrohen gjithashtu të dhënat për praktikantët e nxënësve. Ky sistem është ndihmuar për të siguruar një strukturë të qartë dhe të ndjekur për bashkëpunimet që zhvillohen me biznesin.

b. Dobësitë

Disa pika të dobëta vazhdojnë të mbeten të dukshme nga viti në vit. Një nga problemet kryesore është planifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve me fokus gjinor në bashkëpunim me biznesin. Pavarësisht përpjekjeve nga ana e ofruesve për të adresuar këtë çështje, masat e ndërmarra ende nuk kanë arritur të sjellin rezultate të prekshme në rritjen e barazisë gjinore brenda praktikave të biznesit. Po ashtu, shumë ofrues nuk janë përpikët në realizimin e analizave të tregut për zonën e veprimtarisë së tyre, gjë që ndikon në aftësinë për të përshtatur ofertat dhe shërbimet me kërkesat reale të tregut. Disa ofrues nuk i realizojnë këto analiza për çdo kualifikim që ofrojnë, duke lënë mundësinë për optimizimin e përmbajtjes dhe metodave të trajnimit të mbyllur. Një tjetër dobësi që është evidentuar është vështirësia e Njesisë së Zhvillimit të disa ofruesve për të identifikuar punonjës të kualifikuar në bizneset përkatëse. Ky problem kufizon mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve mësimore dhe profesionale të pasura dhe të përmbajtura, që mund të përfitojnë nga ekspertiza e këtyre punonjësve.

4. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis vet ofruesve të AFP-së dhe institucioneve

a. Rezultati


Ofruesit e AFP-së kanë krijuar marrëdhënie të qëndrueshme me shkollat e arsimit bazë dhe komunitetin, duke mundësuar zhvillimin e aktiviteteve të këshillimit të karrierës dhe promovimin e ofrimit të AFP-së përmes ditëve të hapura, panairëve, konferencave dhe komunikimeve online.

Këto aktivitete janë dokumentuar dhe ruajtur si pjesë e aktiviteteve të planifikuara. Pavarësisht këtij angazhimi, bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë mbetet i kufizuar, pa marrëveshje binjakëzimi të qëndrueshme. Ofruesit kanë mundur të krijojnë disa lidhje, por ato janë sporadike dhe nuk kanë shpërthyer në bashkëpunime të strukturuar me këto institucione.


b. Dobësitë

Marrëdhëniet me shoqërinë civile dhe komunitetin vazhdojnë të përballen me vështirësi. Shumë ofrues ende hasin probleme në krijimin e binjakëzimeve me institucione të arsimit të lartë dhe në përfshirjen e OJF-ve në aktivitete që lidhen me nevojat e tregut të punës dhe projekte të barazisë gjinore. Ndërkohë, bashkëpunimi me prindërit ka përparuar në disa raste, por ende mbeten sfida për përfshirjen e tyre aktive në vlerësimin e brendshëm dhe aktivitete të tjera. Vështirësitë me identifikimin dhe mirëmbajtjen e databazave për OJF-të, si dhe mungesa e bashkëpunimit në projektet zhvillimore dhe trajnimet me shoqërinë civile, janë gjithashtu pika të dobëta që kërkojnë përmirësim të menjëhershëm. Po ashtu, ka ende mangësi në zbatimin e veprimtarive që përfshijnë aspekte gjinore.

Në formë grafike rezultati i fushës për ofruesit e AFP-së do të paraqitet si më poshtë.



Nga analiza e ofruesve të AFP-së për fushën “Marrëdhëniet dhe Bashkëpunimi” ka rezultuar se 26 prej tyre e shohin vetën “Shumë mirë” në këtë fushë, 15 prej tyre e shohin vetën “Mirë”, asnjë ofrues nuk e ka vlerësuar veten Mjaftueshëm dhe “Dobët. Të dhënat janë paraqitur në figurën e mëposhtme:



FUSHA 3-KURRIKULA E ZBATUAR

Kjo fushë lidhet me zhvillimin e kurrikulës së ofruesit të AFP-së në përputhje me standardet e profesioneve dhe standardet e kualifikimeve profesionale dhe mundëson formimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave profesionale. Fusha 3 përbëhet nga 5 nënfushat si më poshtë:

1. Kurrikula me bazë shkolle të AFP-së
2. Kurrikula në bazë ofruesi të FP-së
3. Kurrikula e formimit të përgjithshëm
4. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës
5. Ekipi kurrikular

1. Kurrikula me bazë shkolle të AFP-së

a. Rezultati

Kurrikula me bazë shkollë në institucionet e AFP-së plotësohet në përputhje me kërkesat e standardeve kombëtare nga shkollat e arsimit profesional. Plani për zhvillimin e orëve mësimore teorike dhe moduleve praktike hartohet dhe zbatohet sipas kurrikulave të miratuara nga AKAFPK, duke ruajtur objektivat dhe kërkesat përkatëse për secilin nivel. Këto plane miratohen nga drejtori i shkollës dhe zbatohet në mënyrë të strukturuar dhe të dokumentuar.

b. Dobësitë

Për këtë nënfushë, nuk janë identifikuar dobësi të theksuara në nivel kombëtar. Sipas analizave të raporteve të vetëvlerësimit dhe të dhënave të mbledhura nga platforma scvet.al, nuk ka pasur

probleme të theksuara që kërkojnë përmirësime të menjëhershme, duke treguar një zbatim të qëndrueshëm dhe të përputhshëm me kërkesat.

2. Kurrikula në bazë ofruesi të FP-së

a. Rezultati

Ky kriter plotësohet me sukses nga Qendrat e Formimit Profesional (QFP) dhe shkollat që ofrojnë kurse të unifikuara. Programet e kurseve zhvillohen në përputhje me dokumentet zyrtare dhe nevojat e tregut të punës. Vlerësimet e ofruesve për vetveten janë pozitive, me shumë prej tyre duke u vlerësuar me "shumë mirë" ose "mirë" për zbatimin e kurrikulës".

b. Dobësitë

Një mangësi e identifikuar është se dy QFP kanë raportuar për nevojat e identifikuar për kurset, por këto nuk janë realizuar për shkak të mungesës së burimeve materiale. Një QFP tjetër ka deklaruar se realizon çdo vit analiza të nevojave të tregut lokal dhe rajonal, por këto analiza nuk dokumentohen në mënyrë të duhur.

3. Kurrikula e formimit të përgjithshëm

a. Rezultati

Kurrikula e formimit të përgjithshëm plotësohet vetëm nga shkollat, pasi vetëm në to zhvillohen lëndët e kulturës së përgjithshme. Sipas analizave, u konstatua se planet tremujore dhe vjetore hartohen në përputhje me dokumentet kurrikulare, duke përcaktuar shpërndarjen e kohës dhe elementët e nevojshëm. Mësuesit zhvillojnë aktivitete dhe detyra sfiduese për nxënësit, duke i nxitur ata të trajtojnë çështje të rëndësishme që kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave të tyre. Po ashtu, bëhen përpjekje për të organizuar veprimtari të diferencuara për nxënësit me nevoja të veçanta.

b. Dobësitë

Nga analiza e raporteve të vetëvlerësimit për vitin shkollor 2023-2024, del se rreth gjysma e ofruesve të AFP-së nuk kanë bashkëpunim të mjaftueshëm me prindërit për realizimin e projekteve kurrikulare, dhe kur ndodhin, ato janë të pakta dhe jo sistematike. Po ashtu, çështjet e barazisë gjinore trajtohen vetëm në disa lëndë dhe shpesh mungojnë në detyrat dhe punët e pavarura që mësuesit hartojnë. Ndërkohë, shumë ofrues nuk planifikojnë se cilët nxënës do të vlerësohen në planet ditore, dhe raportet përfundimtare të projekteve shpesh mungojnë ose nuk përmbajnë elementët e kërkuar nga vetëvlerësimi. Këto janë dobësi të cilat kanë qenë të pranishme edhe nga vitet e kaluara.

4. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës

a. Rezultati

Nxënësit e AFP-së vijojnë të kenë tekste mësimore për lëndët e kulturës së përgjithshme, të cilat zbatohen sipas procedurave zyrtare të MAS. Për lëndët e kulturës profesionale, ofruesit mbështeten në materialet mësimore mbështetëse nga AKAFPK dhe ato të siguruara nga mësimdhënësit. Ofruesit kanë mjedise të specializuara për zhvillimin e orëve praktike dhe mjetet e nevojshme për kualifikimet dhe kurset që ofrojnë. Masat për sigurinë gjatë aktiviteteve praktike janë gjithashtu të siguruara, dhe mësimdhënësit bashkëpunojnë me nxënësit për krijimin e mjeteve mësimore. Po ashtu, mësimdhënësit janë të përfshirë në përzgjedhjen e teksteve mësimore.

b. Dobësitë

Një problem i vazhdueshëm është mungesa e bashkëpunimit të prindërve për krijimin e mjeteve mësimore, e cila shpesh është e kufizuar për shkak të statusit social-ekonomik të familjeve. Gjithashtu, disa ofrues nuk janë të pajisur me laboratorë të shkencave natyrore për lëndët e kulturës së përgjithshme, dhe mjediset për edukimin fizik janë të pasigurta ose të papërshtatshme për realizimin e orëve të kësaj lënde. Ka një mungesë të theksuar të teksteve profesionale, megjithatë, mësimdhënësit e kulturës profesionale bëjnë përpjekje për t'i hartuar ato vetë, duke ndjekur kërkesat e skeletkurrikulave.

5. Ekipi kurrikular


a. Rezultati

Ofruesit e AFP-së kanë ngritur ekipe të dedikuara për lëndët e kulturës së përgjithshme dhe lëndët profesionale, duke zhvilluar dhe miratuar programet e mësimdhënies për lëndët teorike dhe praktike. Propozimet për projektet e nxënësve bëhen nga ekipet e kurrikulës së formimit të përgjithshëm.


b. Dobësitë

Është arritur në përfundimin se nuk ka përfshirje të mjaftueshme të prindërve në mbledhjet e departamenteve.

Rezultati i fushës 3 për 41 ofruesit publikë dhe jo publikë të AFP-së paraqitet në këtë mënyrë.



Nga analiza e ofruesve të AFP-së për fushën 3: “Kurrikula e zbatuar”, është arritur në përfundimin se 23 ofrues publikë dhe jo publikë të AFP-së, e kanë vlerësuar veten “Shumë mirë”, 18 prej tyre e kanë vlerësuar vetën “Mirë”. Nuk ka asnjë ofrues AFP-je që e ka vlerësuar veten “Mjaftueshëm” ose “Dobët”.



FUSHA 4 –MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT

Kjo fushë lidhet me dy procese thelbësore të cilat synojnë përvetësimin e njohurive, shprehive dhe kompetencave kyçe dhe profesionale të nxënësit/kursantët në përmbushje të kërkesave të standardeve të profesioneve dhe kualifikimeve profesionale.

Fusha 4 përbëhet nga 9 nënfushat në vijim:

- 1.Plani ditor
- 2.Rezultatet mësimore
- 3.Parimet kryesore gjatë orës së mësimi
- 4.Ana Shkencore
- 5.Baza materiale dhe didaktike
6. Mjedis fizik
- 7.Metodologjia
- 8.Detyrat e shtëpisë
- 9.Përsëritja
- 10.Mjedis i sigurt për të nxënë
- 11.Nxënës dhe kursanti me nevojë të veçanta

1. Plan ditor

a. Rezultati

Mësimdhënësit dhe instruktorët përcaktojnë gjithashtu mjetet dhe materialet didaktike të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Ata hartojnë planet ditore të orëve mësimore duke respektuar programet e mësimdhënies për lëndët teorike dhe ato praktike profesionale, si dhe duke gëzuar autonomi profesionale në këtë proces. Planet mësimore përmbajnë elementët e domosdoshëm si: temën e orës, rezultatet e parashikuara sipas programit, rezultatet konkrete të orës, planifikimin e veprimtarive, vlerësimin, detyrat e shtëpisë dhe reflektimin. Gjatë hartimit të planit, mësimdhënësit parashikojnë kohën për secilën veprimtari të orës, përfshirë prezantimin e njohurive të reja, përsëritjen, reflektimin, vlerësimin si dhe detyrat për në shtëpi.

b. Dobësitë

Nga të dhënat e vetëvlerësimit është konstatuar se rezultatet e orës mësimore që lidhen me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e synuara – përfshirë edhe edukimin mbi barazinë gjinore – nuk raportohen rregullisht nga të gjithë mësimdhënësit dhe instruktorët. Në disa raste, rezultatet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore mungojnë plotësisht ose nuk pasqyrohen siç duhet në planifikimet ditore. Gjithashtu, mësimdhënësit shpesh nuk përfshijnë në planin ditor informacione të rregullta për mangësitë tipike të nxënësve dhe kursantëve që hasin vështirësi në të nxënë. Këto

mangësi ndikojnë në cilësinë dhe përshtatjen e procesit mësimor sipas nevojave individuale të nxënësve.

2. Rezultatet mësimore

a. Rezultati

Objektivat që duhen arritur në orën mësimore prezantohen nga mësimdhënësit dhe instruktorët në fillim të orës, ndërsa në fund të saj vlerësohet niveli i arritjeve për secilin nxënës apo kursant. Tekstet dhe materialet mësimore që përgatiten nga mësimdhënësit janë të lidhura ngushtë me objektivat dhe rezultatet që synohet të realizohen. Herë pas here, për të verifikuar përvetësimin e njohurive, zhvillohen miniteste të rregullta lidhur me rezultatet e orës mësimore. Nga analiza e të dhënave të vetëvlerësimit dhe platformës scvet.al, rezulton se ofruesit e AFP-së zbatojnë me përpikmëri kohën e planifikuar për çdo veprimtari mësimore.

b. Dobësitë

Vetëm një numër i kufizuar nxënësish arrin të përmbushë rezultatet e nivelit të lartë të orës mësimore, ndërkohë që një pjesë e mirë e nxënësve dhe kursantëve nuk arrijnë as nivelin mesatar – kjo, në varësi të nivelit të klasës. U vërejt se jo në të gjithë ofruesit e arsimit dhe formimit profesional, plani i orës mësimore nuk garanton përfshirjen e plotë të nxënësve në arritjen e objektivave të planifikuara. Kjo përbën një dobësi të theksuar të nënfushës, e identifikuar përmes analizës së të dhënave dhe vetëvlerësimit.

3. Parimet kryesore gjatë orës së mësim

a. Rezultati

Nxënësve dhe kursantëve u kërkohet që të mos mjaftohen vetëm me shtjellimin teorik të lëndës, por të lidhin njohuritë me situata reale, duke i konkretizuar ato me shembuj dhe ngjarje nga jeta e përditshme. Gjatë procesit mësimor, mësimdhënësit sigurojnë një trajtim të barabartë për të gjithë nxënësit, si në ndarjen ashtu edhe në dhënien e detyrave. Një objektiv i rëndësishëm është integrimi i njohurive të reja me ato të fituara më parë, si nga e njëjta lëndë ashtu edhe nga lëndë apo module të tjera. Gjithashtu, mësimdhënësit angazhojnë vazhdimisht nxënësit dhe kursantët me sfida të të nxënësve që janë në përputhje me nivelin e tyre të të nxënësve.

b. Dobësitë

Në këtë nënfushë nuk janë identifikuar mangësi që të mund të përgjithësohen në nivel kombëtar.

4. Ana Shkencore

a. Rezultati

Mësimdhënësit dhe instruktorët zotërojnë njohuri të mjaftueshme për të ofruar shpjegime lidhur me marrëdhëniet shkencore të lëndës me disiplina të tjera, si dhe për të treguar lidhjet mes aftësive

praktike të fituara më parë dhe atyre që kërkohen në vijim. Ata demonstrojnë një nivel të lartë përgatitjeje në zgjidhjen e kërkesave të ndryshme të tekstit si ushtrime apo problema, dhe përgjigjen saktë ndaj pyetjeve të nxënësve. Gjithashtu, ata nuk paraqesin mangësi në zotërimin e koncepteve themelore bashkëkohore të lëndës/modulit, në lidhjet mes tyre dhe në përdorimin e metodave moderne të mësimdhënies interaktive. Aftësia për të integruar këto njohuri në mënyrë efektive e bën procesin mësimor më të plotë.

b. Dobësitë

Në bazë të të dhënave nga raportet e vetëvlerësimit, nuk janë evidentuar mangësi në këtë nënfushë që të kërkojnë ndërhyrje ose përmirësim.

5. Baza materiale dhe didaktike

a. Rezultati

Mësimdhënësit dhe instruktorët shpesh përgatisin vetë mjete mësimore që lidhen drejtpërdrejt me arritjen e objektivave mësimore, ndërsa në disa raste bashkëpunojnë edhe me nxënësit për krijimin e tyre. Baza materiale dhe didaktike e planifikuar për zhvillimin e mësimit përdoret në mënyrë të plotë gjatë orës mësimore. Mësuesit përfshijnë përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor, në varësi të përmbajtjes dhe objektivave të lëndëve të kulturës së përgjithshme dhe profesionale. Gjithashtu, mjetet bazike për zhvillimin e orës – si tekstet, fletoret – janë të disponueshme për nxënësit.

b. Dobësitë

Në disa ofrues të AFP-së mungojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme të punës për zhvillimin e detyrave individuale ose në grup gjatë praktikës profesionale. Edhe pse kjo situatë nuk është e përhapur në shumicën e ofruesve, ajo mbetet një çështje që kërkon ndërhyrje për të garantuar cilësi në formimin praktik të nxënësve. Një tjetër dobësi është mungesa e bashkëpunimit të mësimdhënësve me prindërit dhe komunitetin në sigurimin e mjeteve mësimore. Arsyeja kryesore për këtë është pamundësia financiare e prindërve për të kontribuar në krijimin e mjeteve ndihmëse për lëndët mësimore.

6. Mjedisi fizik

a. Rezultati

Hapësirat fizike në klasë dhe në ambientet e praktikës janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur metodologjitë e përzgjedhura mësimore. Mjediset mundësojnë vendosjen në vende të dukshme të punimeve individuale, të ekipeve të vogla apo të klasës, në përputhje me kualifikimin profesional ose kursin përkatës. Nxënësit dhe kursantët kanë liri të plotë për të lëvizur dhe komunikuar gjatë mësimit, çka i ndihmon ata në organizimin dhe zhvillimin e punës në grupe të vogla. Mjedisi fizik mbështet në mënyrë efektive zhvillimin e procesit mësimor dhe praktik.

b. Dobësitë

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë
Tel. +355 42237087

Web site: www.akafp.gov.al

Të dhënat nga vetëvlerësimi dhe platforma scvet.al nuk evidentojnë mangësi të theksuara në këtë nënfushë që të kërkojnë ndërhyrje ose përmirësim.

7. Metodologjia

a. Rezultati

Hapësirat fizike në klasë dhe në ambientet e praktikës janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur metodologjitë e përzgjedhura mësimore. Mjediset mundësojnë vendosjen në vende të dukshme të punimeve individuale, të ekipeve të vogla apo të klasës, në përputhje me kualifikimin profesional ose kursin përkatës. Nxënësit dhe kursantët kanë liri të plotë për të lëvizur dhe komunikuar gjatë mëimit, çka i ndihmon ata në organizimin dhe zhvillimin e punës në grupe të vogla. Mjedisi fizik mbështet në mënyrë efektive zhvillimin e procesit mësimor dhe praktik.

b. Dobësitë

Nuk janë evidentuar dobësi të theksuara për këtë nënfushë, nga ana e ofruesve të AFP-së, me përjashtim të faktit se ora mësimore është e hapur për pjesëmarrjen e të interesuarve, si: kolegë, prindër, etj, pavarësisht se palët e ftuara nuk paraqiten gjithmonë. Prindërit, për arsye të ndryshme, nuk kanë përfshirje të gjerë në orët mësimore.

8. Detyrat e shtëpisë

a. Rezultati

Detyrat e shtëpisë u jepen rregullisht nxënësve nga shumica e mësimdhënësve, kryesisht në shkollë, më shumë sesa në Qendrat e Formimit Profesional. Këto detyra nuk synojnë vetëm riprodhimin e njohurive të mësuara, por kërkojnë edhe zbatimin e tyre në situata praktike të jetës reale. Projektet kurrikulare, përveçse përfshijnë përdorimin e TIK-ut, i inkurajojnë nxënësit të punojnë në grup. Në fund të orës mësimore, mësimdhënësit i sqarojnë detyrat për nxënësit dhe më pas i kontrollojnë rregullisht ato, qoftë me gojë apo përmes komenteve në fletore. Në raste të caktuara, edhe vetë detyrat e shtëpisë përfshijnë kërkesa që lidhen me përdorimin e TIK-ut.

b. Dobësitë

Për shkak të distancave të largëta midis nxënësve, detyrat e shtëpisë që u caktohen janë kryesisht individuale dhe nuk favorizojnë punën në grup – ndryshe nga projektet kurrikulare, të cilat e përfshijnë këtë aspekt. Po ashtu, detyrat e shtëpisë nuk u japin nxënësve mundësi të zgjedhin vetë kërkesat për realizim. Për më tepër, përfshirja e situatave që lidhen me edukimin për barazinë gjinore në detyrat e shtëpisë është e kufizuar dhe jo e qëndrueshme. Nga analiza e të dhënave në raportet e vetëvlerësimit, është konstatuar se TIK-u nuk përdoret në provimet me shkrim, përveç rasteve gjatë pandemisë kur mësimi ishte online.

9. Përsëritja

a. Rezultati

Mësimdhënësit, gjatë orëve të përsëritjes, nxisin pjesëmarrjen aktive dhe të pavarur të nxënësve dhe kursantëve, duke i përfshirë ata në detyra individuale, si dhe në grupe të vogla ose të përziera gjinore, sipas rastit. Ata synojnë që, në çdo përsëritje kapitulli, t'i udhëzojnë nxënësit në identifikimin e lidhjeve ndërmjet koncepteve të kapitullit aktual dhe atyre të kapitujve të mëparshëm të së njëjtës lëndë. Drejtori i institucionit të IoAFP-së organizon një provim vjetor me shkrim për disa lëndë dhe module, si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të nxënësve. Kjo praktikë është reflektuar në të dhënat e vetëvlerësimit për vitin shkollor 2023–2024.

b. Dobësitë

Në këtë nënfushë nuk janë evidentuar problematika që të kërkojnë ndërhyrje apo përmirësime të menjëhershme.

10. Mjedis i sigurt për të nxënit

a. Rezultati

Mjediset fizike të klasave dhe të praktikës janë vlerësuar si të përshtatshme për zhvillimin e orëve mësimore, sipas të dhënave të mbledhura përmes procesit të vetëvlerësimit në të gjithë ofruesit. Nxënësve dhe kursantëve u ofrohet mundësia të punojnë lirshëm në ekipe të vogla falë hapësirës së mjaftueshme dhe mjedisit të favorshëm për bashkëpunim. Ata gjithashtu kanë mundësi të komunikojnë dhe të lëvizin lirshëm brenda klasës. Punimet individuale dhe ato në grup afishohen në vende të dukshme, si në klasa ashtu edhe në ambiente praktike, duke i dhënë nxënësve mundësinë e vlerësimit dhe përfshirjes aktive në procesin mësimor.

b. Dobësitë

Për këtë nënfushë, nuk janë konstatuar dobësi që të kërkojnë ndërhyrje apo përmirësime.

11. Nxënësit dhe kursanti me nevoja të veçanta



a. Rezultati

Procesi mësimor në institucionet e IoAFP-së synon mbështetjen e nxënësve dhe kursantëve me nevoja të veçanta, përmes dhënies së detyrave të përshtatura të klasës dhe të shtëpisë. Mësimdhënësit përpiqen të përshtatin përmbajtjen dhe metodat sipas nivelit të të nxënit të këtyre nxënësve, duke bërë komente dhe duke i lavdëruar për arritjet dhe përpjekjet e tyre. Gjithashtu, në klasë, ata marrin mbështetje edhe nga bashkëmoshatarët e tyre, duke nxitur një mjedis përfshirës dhe bashkëpunues. Të dhënat e platformës scvet.al dhe raportet e vetëvlerësimit konfirmojnë këtë përkushtim për përfshirjen efektive të nxënësve me aftësi të kufizuara apo me nevoja të veçanta.

b. Dobësitë

Megjithëse kjo situatë nuk është e përhapur në të gjithë ofruesit e AFP-së, në disa raste është konstatuar se materialet mësimore të përzgjedhura për nxënësit dhe kursantët me nevoja të veçanta

Në grafikun e mposhtëm tregohet vlerësimi për secilin prej 41 ofruesve publikë dhe jo publikë të AFP-së për fushën 4 “Mësimdhënia dhe të nxënët”.



FUSHA 5 - VLERËSIMI

Procesi i vlerësimit përfshin vlerësimin periodik dhe përfundimtar të njohurive të nxënësve apo kursantëve, me qëllim kryesor matjen e përparimit të tyre në kuadër të programeve të ndjekura dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të të nxënës.

Vlerësimi luan një rol thelbësor jo vetëm në përcaktimin e nivelit të arritjeve, por edhe në motivimin e nxënësve/kursantëve, duke u ofruar atyre feedback të vlefshëm mbi ecurinë përmes komunikimit me mësuesin/instruktorin. Kjo fushë përbëhet nga gjashtë nënfusha:

1. Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit
2. Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/kursantit
3. Procesi i vlerësimit
4. Arritjet
5. Rivlerësimi
6. Ankimimet

1. Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit

a. Rezultati

Procesi i vlerësimit periodik të nxënësve dhe kursantëve është kthyer tashmë në një praktikë të qëndrueshme dhe të institucionalizuar. Mësimdhënësit zbatojnë teste apo detyra përmbledhëse në përputhje me udhëzimet zyrtare, të cilat dokumentohen rregullisht dhe në mënyrë të standardizuar. Ky proces është bërë pjesë integrale e kulturës mësimore në institucionet e AFP-së.

b. Dobësitë

Në këtë nënfushë nuk janë evidentuar problematika që lidhen me zbatimin e procesit të vlerësimit periodik.

2. Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/kursantit

a. Rezultati

Procedurat për organizimin dhe administrimin e provimeve përfundimtare në institucionet e arsimit profesional zbatohen me përpikmëri dhe pa problematika evidente. Ofruesit i respektojnë kriteret zyrtare për përcaktimin e notave përfundimtare vjetore. Vlerësimi përfundimtar, përfshirë edhe Provimet Përfundimtare të niveleve realizohet në mënyrë të rregullt nga IoAFP-të.

b. Dobësitë

Një sfidë e përsëritur, edhe gjatë këtij viti të vetëvlerësimit, mbetet përfshirja e përfaqësuesve të bizneseve në komisionet e vlerësimit përfundimtar të praktikës profesionale, çka është konstatuar në disa prej ofruesve të AFP-së.

3. Procesi i vlerësimit

a. Rezultati

Përmes një qasjeje të strukturuar ndaj procesit të vlerësimit, mësimdhënësit kanë ndërtuar programet e tyre të vlerësimit të nxënësve, të cilat përfshijnë instrumente dhe metoda të ndryshme. Ata jo vetëm që vlerësojnë përvetësimin e njohurive dhe ecurinë e nxënësve, por gjithashtu identifikojnë mangësitë dhe punojnë për të nxitur motivimin dhe interesin e tyre për të mësuar. Këto programe janë hartuar në bazë të standardeve dhe udhëzimeve përkatëse të vlerësimit.

b. Dobësitë

Në disa ofrues, teknikat e vlerësimit nga vetë nxënësit (vetëvlerësimi i nxënësve) dhe vlerësimi i ndërsjellë ndërmjet tyre mbeten ende të pakonsoliduara dhe përdoren rrallë ose në mënyrë të pasistemuar. Raportet e vetëvlerësimit tregojnë se këto forma vlerësimi nuk janë të dokumentuara rregullisht dhe përbëjnë një sfidë të vazhdueshme për një pjesë të institucionit.

4. Arritjet

a. Rezultati

Provimet përfundimtare zhvillohen me sukses, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe udhëzimet zyrtare të institucioneve përkatëse. Ofruesit e arsimit dhe formimit profesional (AFP) kryejnë analiza të hollësishme të arritjeve të nxënësve dhe kursantëve në disa dimensione të ndryshme. Këto analiza përfshijnë krahasimin mes rezultateve të Maturës Shtetërore dhe vlerësimit të brendshëm, si dhe shqyrtimin e rezultateve të provimeve të teorisë profesionale të integruar dhe të kurseve të unifikuara për kursantët. Përveç kësaj, gjatë procesit mësimor, mësimdhënësit ruajnë një komunikim të vazhdueshëm me prindërit për t'i informuar mbi ecurinë dhe arritjet e nxënësve.

b. Dobësitë

Një nga sfidat e raportuara është përfshirja e përfaqësuesve të biznesit në komisionet e provimeve përfundimtare të teorisë dhe praktikës profesionale. Gjithashtu dhe mungesa e aksesit në testet e Maturës Shtetërore, gjë që e pengon disa ofrues të analizojnë me saktësi qartësinë dhe nivelin e të kuptuarit të pyetjeve nga nxënësit. Për këtë arsye ofruesit e AFP-së nuk kanë mundësi të bëjnë krahasime të plota midis rezultateve të këtyre provimeve dhe vlerësimit që nxënësit marrin në shkollë.

5. Rivlerësimi

a. Rezultati

Procesi i rivlerësimit është i bazuar në kuadër ligjor dhe ofron mundësinë që nxënësit apo kursantët të kërkojnë një rivlerësim të rezultateve të tyre kur lind nevoja. Sipas deklarimeve të ofruesve të AFP-së, ky mekanizëm nuk përdoret shpesh në praktikë, por mbetet funksional dhe i zbatueshëm në rastet e parashikuara.

b. Dobësitë

Në lidhje me këtë nënfushë, nuk janë evidentuar problematika.

6. Ankimimet


a. Rezultati

Ofruesit e arsimit dhe formimit profesional kanë përfshirë në rregulloret e tyre institucionale procedura të qarta ankimimi, duke përmbushur kështu detyrimet ligjore në këtë drejtim. Çdo ankesë që paraqitet trajtohet sipas procedurave të parashikuara dhe përgjigjet jepen brenda afateve të përcaktuara në rregulloret përkatëse. Kjo tregon se sistemi i ankimimeve është funksional në shumicën e ofruesve.


b. Dobësitë

Nuk janë raportuar dobësi në këtë nënfushë nga ofruesit e AFP-së.


Në formë grafike rezultati i fushës për ofruesit e AFP-së do të paraqitet si më poshtë.



Nga analiza e ofruesve të AFP-së për fushën “Vlerësimi” ka rezultuar se 33 prej tyre e shohin vetën “Shumë mirë” në këtë fushë, 8 prej tyre e shohin veten “Mirë”, ndërkohë asnjë ofrues nuk e ka vlerësuar veten “Mjaftueshëm” ose “Dobët”. Të dhënat janë paraqitur në figurën e mëposhtme:



Në grafikun e mëposhtëm paraqitet për secilën prej fushave të vetëvlerësimit, në nivel kombëtar për të gjithë ofruesit publikë dhe jo-publikë të AFP-së është 1.44.



GJETJE TË EVIDENTURA NË RAPORTET E VETËVLERËSIMIT

Analiza e raporteve të vetëvlerësimit të ofruesve të formimit profesional (IoAFP), në nivel kombëtar, ka nxjerrë në pah disa çështje, të cilat kërkojnë adresim në ciklin e ardhshëm të vetëvlerësimit:

1. Mospërdorim efektiv i analizës SWOT

Analiza SWOT, e cila u mundëson ofruesve të AFP-së të identifikojnë potencialin e ardhshëm, pikat e forta dhe të dobëta, vazhdon të jetë një pikë e dobët për disa nga Institucionet ofruese të AFP-së (IoAFP). Në shumë raste, kjo analizë nuk paraqitet në formatin e duhur ose mungojnë një ose më shumë nga elementët përbërës të saj. Në disa raste, IoAFP-të ripërdorin (copy-paste) pjesë nga raportet e vetëvlerësimit të viteve të mëparshme, pa e reflektuar realisht gjendjen aktuale. Nuk mungojnë as rastet kur pikat e paraqitura janë të paqarta, të përgjithshme dhe jo të specifikuara siç duhet.

2. Mospërputhje me normat e shkrimit zyrtar

Ka një përmirësim të përgjithshëm në cilësinë e raporteve të vetëvlerësimit krahasuar me vitin e kaluar por në raportet e përgatitura nga ofruesit ende evidentohet përdorimi jo korrekt i elementeve të gjuhës standarde, sidomos në përdorimin e shkronjave specifike të shqipes si “ë” dhe “ç”. Ky aspekt ndikon negativisht në profesionalizmin dhe imazhin e institucionit si ofrues arsimor.

3. Zhvillimi i instrumentit për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë

Instrumenti për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë është vështirësia më e madhe që hasin ofruesit e AFP-së në raportet e vetëvlerësimit. Në disa raste, rekomandimet e hartuara nga ofruesit e AFP-së nuk janë në përputhje me instrumentin përkatës për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Kjo mospërputhje krijon vështirësi në identifikimin dhe trajtimin e çështjeve që kërkojnë përmirësim në të ardhmen. Gjithashtu, vihet re se një pjesë e ofruesve nuk e kanë të qartë strukturën dhe elementet përbërëse të këtij instrumenti, gjë që ndikon negativisht në zbatimin efektiv të tij. Disa ofrues të AFP-së hasin vështirësi në hartimin e objektivave SMART. Shpesh përdoren objektiva të formuluar në mënyrë të përgjithshme, pa përcaktuar qartë afatet kohore. Në disa raste, mungon përshtatja e veprimtarisë që do të ndërmerret për realizimin e objektivit, nuk respektohet rendi kronologjik i veprimeve, ose veprimtaritë e listuara nuk kanë lidhje logjike me njëra-tjetrën për arritjen e objektivit. Gjithashtu, janë evidentuar raste kur mungon treguesi sasior i përmbyshjes ose kur treguesit janë formuluar në mënyrë jo të qartë apo jo të përshtatshme.

REKOMANDIME

FUSHA 1

Nënfusha 1

1. Të bëhen përpjekje për angazhimin e prindërve në Këshillin e Prindërve sipas një plani pune të hartuar.

Nënfusha 2

2. Të punohet më tepër për zbatimin dhe monitorimin e planit afatmesëm duke dokumentuar punën.

Nënfusha 3

3. Të hartohen objektiva që pasqyrojnë veprimtari me aspekte gjinore në planin vjetor dhe atë afatmesëm.

Nënfusha 5

4. Të merren masa për bërjen e librit të inventarit si dokument transparent për IoAFP dhe komunitetin.

Nënfusha 7

5. Të realizohet vetëvlerësimi nëpërmjet një instrumenti standard për mësimdhënësit dhe ekipeve të drejtimit profesional.
6. Të mirëmbahen apo krijohen faqet e internetit të ofruesve për publikimin e raportit përfundimtar të vetëvlerësimit.

Nënfusha 9

7. Të merren masa për të nxitur pjesëmarrjen e të gjithë mësimdhënësve në veprimtari të ndërkurrikulare që organizojnë ekipet ku përfshihen apo institucioni në tërësi.

FUSHA 2

Nënfusha 1

8. Të planifikohen dhe zbatohen veprimtari me aspekte gjinore në bashkëpunim me institucionet vendore në vitet në vijim.

Nënfusha 2

9. Të zhvillohet analiza periodike e tregut për zonën ku IoAFP-të zhvillojnë veprimtarinë, e detajuar dhe për të gjitha kualifikimet profesionale si dhe për të vlerësuar nevojën për kualifikime të reja profesionale.

10. Të identifikohen nga NJZH punonjës të kualifikuar në biznese për të zhvilluar tema të ndryshme në shkollë.

Nënfusha 3

11. Të planifikohen dhe zbatohen veprimtari me aspekte gjinore në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe OJF-të pasi ka qenë mungesë e theksuar për disa vite deri më tani.

Nënfusha 4

12. Të lidhen marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e Arsimit të Lartë dhe arsimit post sekondar me qëllim përgatitjen profesionale të nxënësve/kursantëve, trajnimin e stafit dhe përmirësimin dhe rifreskimin e kurrikulës së përgatitjes profesionale dhe hartimin e materialeve mbështetëse.

FUSHA 3

Nënfusha 4

13. Të bëhen përpjekje për sigurimin e teksteve profesionale në ofrues, mangësi e cila ekziston prej disa vitesh.

FUSHA 4

Nënfusha 1

14. Rekomandohet që mësime ndërmjet të përcaktojnë në planet ditore:

- të dhëna mbi mangësitë e nxënësve dhe kursantëve me vështirësi në të nxënë.

Nënfusha 5

15. Të nxitet bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin në krijimin e mjeteve mësimore.

Nënfusha 8

16. Të përfshihen në detyrat e shtëpisë situata të të nxënës që lidhen me edukimin dhe barazinë gjinore.

Nënfusha 11

17. Të përzgjidhen materiale mësimore të përshtatshme për nxënësit me nevoja të veçanta, të përshtatura me llojin e aftësisë së kufizuar.

18. Të bëhet kërkesë në institucionet përgjegjëse për punësimin e një mësuesi ndihmës, në ofruesit që kanë nxënës me nevoja të veçanta.

19. Të hartohen planet PEI për nxënësit me nevoja të veçanta në bashkëpunim me mësuesit ndihmës dhe psikologun e shkollës (nëse ka).

FUSHA 5

Nënfusha 2

20. Të nxitet pjesëmarrja e përfaqësuesve të biznesit për rëndësinë e pjesëmarrjes në komisionet e vlerësimit përfundimtar të praktikës profesionale.

Nënfusha 3

21. Të zbatohen herë pas here teknika e “vetëvlerësimit të nxënësit/kursantit” si dhe “vlerësimi për njëri-tjetrin” në të gjitha në të gjithë ofruesit e AFP-së.